



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



A.nr.1823/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1823/2025, të datës 21.10.2025, të parashtruar nga ankuesi SH.E, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Hilmi Shala, kundër organit të punësimit: Autoriteti i Konkurrencës së Republikës së Kosovës, në çështjen juridike “*Masë disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.03.2026, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Aprovohet si e bazuar** ankesa më numër A.nr.1823/2025, e datës 21.10.2025, e parashtruar nga ankuesi SH.E, lidhur me shqiptimin e masës së lehtë disiplinore, “*Vërejtje me shkrim*” me numër protokolli 468/25-06/B, e datës 07.10.2025, nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës së Republikës së Kosovës, ndërsa, **hedhet poshtë si i palejuar** pretendimi i ankuesit për anulimin e Vendimit për pezullimin e përkohshëm, me numër protokolli 469/25-13/B të datës 07.10.2025, të Komisionit Disiplinor në Autoritetin e Konkurrencës.

**II. Anulohet** masa disiplinore, “*Vërejtje me shkrim*” me numër protokolli 468/25-06/B, e datës 07.10.2025, e shqiptuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës së Republikës së Kosovës.

**III. Obligohet** Udhëheqësja e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Konkurrencës së Republikës së Kosovës, për zbatimin e këtij vendimi në afat prej pesëmbëdhjete (15) ditësh nga dita e pranimi të tij, duke larguar nga dosja personale masën disiplinore ndaj ankuesit në pajtim me pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

**IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Nëpunësi civil, SH.E (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), përmes përfaqësuesit të autorizuar, më datë 21.10.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës së lehtë disiplinore “Vërejtje me shkrim”, me numër protokolli 468/25-06/B, e datës 07.10.2025, të shqiptuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës së Republikës së Kosovës, si dhe Vendimit me numër protokolli 469/25-13/B të datës 07.10.2025, të Komisionit Disiplinor në Autoritetin e Konkurrencës së Republikës së Kosovës, përmes të cilit akt i njëjti i është pezulluar përkohësisht nga puna, në kohëzgjatje prej tridhjetë (30) ditëve, duke filluar nga data 08.10.2025 deri më 06.11.2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: AKRK), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 04.11.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Autoriteti i Konkurrencës së Republikës së Kosovës, ndërsa kjo e fundit më datë 07.11.2025, ka dorëzuar përgjigjen me provat e bashkangjitura të lëndës.

Tutje, Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së Kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me Vendimin me numër protokolli 7633/2025, të datës 01.12.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.1/2025, të parashtruar nga ankuesi edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit), administroi këto prova:** Ankesën me numër protokolli 6920/2025 të parashtruar me datë 21.10.2025, nga ankuesi në Këshill; Autorizimin e datës 14.10.2025; Vendimin me numër protokolli 469/25-13/B të datës 07.10.2025; Vërejtjen me shkrim me numër protokolli 468/25-06/B të datës 07.10.2025; Procesverbalin e datës 30.09.2025; Inicimin e procedurës disiplinore nga S.B, me e-mailin e datës 06.10.2025 (ora 10:21); Inicimin e procedurës disiplinore nga S.B, me e-mailin e datës 06.10.2025 (ora 9:52); Ftesën për seancë disiplinore, me e-mailin e datës 29.09.2025; ); Inicimin e procedurës disiplinore nga S.B, me e-mailin e datës 25.09.2025 (ora 3:50); ); Inicimin e procedurës disiplinore nga N.B, me e-mailin e datës 25.09.2025 (ora 10:27); Shkresë e ankuesit për Komisionin Disiplinor; E-mailin e datës 15.07.2025, të nga A.R për Sh.E, me korrespondim prej 3 faqeve; E-mailin e datës 10.09.2025, nga Sh.E për N.B, K.S dhe N.O; E-mailin e datës 29.09.2025, nga A.T për S.B, me korrespondim prej 10 faqeve; E-mailin e datës 06.10.2025, nga A.T për Sh.E, me korrespondim prej 3 faqeve; E-mailin e datës 25.09.2025, nga Sh.E për Y.B dhe A.M; E-mailin e datës 06.10.2025, nga S.B për Sh.E, me korrespondim prej 5 faqeve; E-mailin e datës 16.09.2025, nga Sh.E për S.B, R.A, E.T..., me korrespondim prej 4 faqeve; Mesazhe telefonike; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 24.11.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 07.11.2025; Akt emërimit me numër protokolli 332/25-13/B të datës 02.07.2025, me përshkrimin e detyrave të punës; Vërejtjen me shkrim me numër protokolli 3373/25-10/B të datës 29.07.2025; Prova shtesë nga ankuesi të datës 21.11.2025; Vendimin me numër protokolli 510/25-13/B të datës 07.11.2025; E-mailin e datës 19.11.2025, me korrespondim prej 5 faqeve; Kërkesë për prova shtesë të datës

15.12.2025; E-mailin e datës 16.12.2025 (ora 8:09), me korrespondim prej 3 faqeve; E-mailin e datës 16.12.2025 (ora 8:10) me korrespondim prej 5 faqeve.

- Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit, lidhur me shqiptimin e masës së lehtë disiplinore, konstatoi se ankesa **është e bazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedh se ankuesi sipas Akt emërimit me Nr.AE.23/2025 të datës 18.06.2025, është i punësuar në pozitën Inspektor Hetues i Konkurrencës në Divizionin e Marrëveshjeve të Ndaluar-Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut pranë AKRK-së.

Më tej nga shkresat e lëndës rezulton se Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit e organit përkatës të punësimit, duke u bazuar në nenin 55 paragrafin 1, nenin 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, paragrafi 3 nën paragrafët 3.2 dhe 3.3, nenin 57 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3, nenit 58 paragrafin 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, si dhe nenin 31 paragrafin 2 të këtij ligji, me datë 07.10.2025, ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore: “*Vërejtje me shkrim*” me numër protokolli 468/25-06/B, për shkak të keq përdorimit të orarit të punës dhe sjelljes jo të mirë gjatë kohës së punës me mbikëqyrësin, kolegët dhe publikun.

Ndërsa, Komisioni Disiplinor i AKRK-së, bazuar në nenin 59 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, me datë 07.10.2025 ka nxjerrë Vendimin me numër protokolli 469/25-13/B, përmes të cilit ka pezulluar përkohësisht nga puna ankuesin, në kohëzgjatje prej tridhjetë (30) ditëve, duke filluar nga data 08.10.2025 deri më 06.11.2025, për arsye të inicimit të pesë (5) procedurave disiplinore ndaj tij, gjegjësisht dy (2) procedurave disiplinore të datës 25.09.2025 të iniciuar nga Kryetarja e AKRK-së dhe Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të AKRK-së, si dhe tri (3) procedurave disiplinore të iniciuar nga ky i fundit me datë 06.10.2025, duke konstatuar se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga ankuesi, ndaj të cilit ka filluar procedura disiplinore e pengon hetimin disiplinor.

Ankuesi, ka parashtuar ankesë në Këshill, kundër masës së lehtë disiplinore “*Vërejtje me shkrim*”, me numër protokolli 468/25-06/B, e datës 07.10.2025, të shqiptuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të AKRK-së, si dhe Vendimit me numër protokolli 469/25-13/B të datës 07.10.2025, të Komisionit Disiplinor të AKRK-së, përmes të cilit akt i njëjti i është pezulluar përkohësisht nga puna, në kohëzgjatje prej tridhjetë (30) ditëve, duke filluar nga data 08.10.2025 deri më 06.11.2025, për shkak se konsideron se procedura disiplinore nuk është zhvilluar në përputhje me ligjin, respektivisht nuk njoftuar me pretendimet e shkeljeve në kohë ose nuk i është dhënë mundësia me mbrojtjes; se vendimi nuk është i bazuar në prova të mjaftueshme, nuk është dëshmuar përgjegjësia për shkeljen e pretenduar; se masa është disproporcionale me sjelljen e tij; se janë shkelur parimi i objektivitetit, proporcionalitetit dhe të drejtës për mbrojtje, të garantuar me Ligjin për Shërbimin Civil dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Si rrjedhojë, ankuesi kërkon aprovimin e tërësishëm të ankesës, shfuqizimin e “*Vërejtjes me shkrim*”, me numër protokolli 468/25-06/B, të datës 07.10.2025 dhe Vendimit me numër protokolli 469/25-13/B të

datës 07.10.2025, me lejimin që i njëjti të kthehet urgjentisht në pozitën e tij, si dhe të detyrohet organi kompetent (Titullaren/Kryetaren e Autoritetit) për të nxjerrë vendim për pezullimin nga marrëdhënia e punës së drejtorit të përgjithshëm, kur pa të drejtë është refuzuar nxjerrja e tij.

Kolegji i Këshillit, bazuar në të dhënat zyrtare të lëndëve në proces dhe të përfunduara, konstaton se aktin e kontestuar me ankesë nga ankuesi, përkatësisht masën e lehtë disiplinore “*Vërejtje me shkrim*”, me numër protokolli 468/25-06/B, të datës 07.10.2025, e ka nxjerrë Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të AKRK-së, i cili po ashtu me datë 06.01.2025 kishte nxjerrë Vendimin me shifër Nr.08/25-06/B, për transferimin e përkohshëm të ankuesit në pozitën *Inspektor për hetimet e shkelleve të konkurrencës* në kuadër të Divizionit të Pozitës Dominuese në Departamentin për Mbikëqyrjen e Konkurrencës në Autoritetin e Konkurrencës, dhe i cili akt me datë 05.02.2025 ishte kundërshtuar me ankesë pranë Këshillit, ku si rrjedhojë përmes Vendimit A.nr.279/2025 të datës 07.04.2025, ishte aprovuar si e bazuar ankesa e ankuesit, ndërsa është anuluar Vendimi Nr.08/25-06/B i datës 06.01.2025, i Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të AKRK-së.

Me Vendimin A.nr.279/2025 të datës 07.04.2025, Kolegji i Këshillit, i’ a kishte falur besimin provës materiale, gjegjësisht Aktakuzës me shifër PP.II.nr.7334/23 të datës 18.03.2024 të Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm sipas cilës konfirmohet fakti se ndaj S.B, Drejtor i Përgjithshëm në Autoritetin e Konkurrencës, Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë para Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, me arsyetimin se i njëjti, .... *me datë 29.11.2023 në Zyrën e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës, me dashje që ti shkaktoj lëndim trupor personit tjetër (ne rastin konkret, ankuesin SH.E) e kishte sulmuar fizikisht, ... duke kryer veprën penal nga neni 185 paragrafi 1, pika 1.4 të KPRK-së, si dhe Opinionin e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit të datës 04.09.2024 dërguar për Drejtorin e Përgjithshëm në Autoritetin e Konkurrencës, përmes së cilit përcaktohet qartë fakti se Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ndër tjerash në opinion në fjalë lidhur me konfliktin e interesit, ndër të tjerash ka përcaktuar se, **citoj:** “... Rastet kur zyrtari (nëpunësi) duhet të përjashtohet nga procedura administrative janë përcaktuar me nenin 29, 30 dhe 31 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe si rrjedhojë është përgjegjësi e zyrtarit por edhe e udhëheqësit të drejtpërdrejtë dhe e institucionit udhëheqës respektimi i dispozitave përkatëse, në rastet kur plotësohen kushtet për përjashtimi. Palët e përfshira në procedurë kanë të drejtë ankese sipas rregullative të marrëdhënies së punës.”*, duke shtuar faktin se edhe organi i punësimit-Autoriteti i Konkurrencës së Republikës së Kosovës, ka qenë në njohuri për të dyja shkresat e cekura si më lartë.

Rrjedhimisht, duke marrë për bazë dispozitat e nenit 2 paragrafi 1 në paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme administrative, sipas të cilit nen përcaktohet se ky ligj zbatohet në çdo rast kur një organ publik në realizimin e autoritetit publik vendos për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave, si dhe çdo rast tjetër kur ligji parashikon shprehimisht nxjerrjen e një akti administrativ, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit u bazua në nenin 29 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10 të të njëjtit ligj ku përcaktohet se: “*29.1. Një nëpunës nuk duhet të përfshihet në një procedurë administrative, nëse ka një interes personal direkt apo indirekt në çështjen në fjalë, në mënyrë të veçantë kur ndodhet në njërin nga këto situata: 1.10. në çdo situatë tjetër, parashikuar shprehimisht me ligj apo*

*që mund të vë në dyshim paanshmërinë e tij.” dhe, duke qenë se në rastin konkret ekziston gjendja e njëjtë faktike dhe juridike, përkatësisht në atë se aktin e kontestuar me ankesë nga ankuesi e ka nxjerrë i njëjti zyrtar, përkatësisht Drejtori i Përgjithshëm të Sekretariatit të AKRK-së, e mbështetur në nenin 8, të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: 1. Veprimet e organeve publike duhet të jenë të parashikueshme dhe të respektojnë pritshmëritë legjitime dhe të arsyeshme të personave. 2. Një veprim administrativ nuk mund të ndryshojë në mënyrë të pajustificuar nga një praktikë administrative e mëparshme e të njëjtit organ për raste të njëjta a të ngjashme; si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit, konstatoi se “Vërejtja me shkrim”, me numër protokolli 468/25-06/B, e datës 07.10.2025, të shqiptuar ndaj ankuesit nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të AKRK-së, është akt i paligjshëm sikurse përcaktohet me nenin 52 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi që në rrethanat e rastit konkret Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të AKRK-së nuk ka pasur të drejtë ligjore as ti shqiptoj masë disiplinore ankuesit, pasi që sipas Aktakuzës me shifër PP.II.nr.7334/23 të datës 18.03.2024 të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të ngritur para Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, dyshohet se i njëjti ka kryer vepër penale të specifikuar si më lartë, ashtu që ankuesit i kishte shkaktuar lëndim trupor dhe me këtë rast i njëjti është dashur të tërhiqet nga kjo procedurë pasi që kjo rrethanë juridike e vë në dyshim paanshmërinë e tij në rrethanat e rastit konkret.*

Për më tepër bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht me Nenin 55, i cili përcakton se: 1. *Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim.*; Neni 56 paragrafi 1, 2 dhe 3, ku përcaktohet se: 1. *Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. 2. Shkeljet e rënda të detyrave dhe përgjegjësi të punës janë të përcaktuara me ligj, ndërsa shkeljet e lehta janë të përcaktuara me ligj dhe rregulla të brendshme. 3. Shkelje të lehta konsiderohen: 3.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune radhazi; 3.2. mosrespektimi i orarit të punës; 3.3. sjellja jo e mirë gjatë kohës së punës, me mbikëqyrëset/it, koleget/ët, vartëset/it dhe me publikun.*; Neni 57 paragrafi 1, ku përcaktohet se: 1. *Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunës/it civil për shkelje të lehta janë: 1.1. vërejtje verbale; 1.2. paralajmërim me shkrim; 1.3. vërejtje me shkrim.*; Kolegji i Këshillit, konstaton se shkelje e lehtë e nëpunësit civil, parashihet mungesa të paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune radhazi, mosrespektimi i orarit të punës si dhe sjellja jo e mirë gjatë kohës së punës, me mbikëqyrëset/it, koleget/ët, vartëset/it dhe me publikun, ndërsa nga shkresat e bashkangjitura të lëndës nuk rezulton se ankuesi, me veprimet e tij nuk ka respektuar orarin zyrtar të punës, ndaj i njëjti nuk mund të lihet përgjegjës për dërgimin e-mailave të datës 06.10.2025, rrjedhimisht as ti shqiptohet kjo masë disiplinore për shkak të kësaj shkelje të supozuar, përkatësisht keqpërdorimit të orarit të punës, sepse ashtu edhe siç është konstatuar në Vendimin A.nr.1638/2025 të datës 29.10.2025, e njëjta nuk parashihet fare si shkelje e lehtë disiplinore me dispozitat e sapo theksuara ligjore, ndërsa po ashtu edhe për shkeljen tjetër të supozuar, gjegjësisht për sjellje jo të mirë gjatë kohës së punës, me mbikëqyrëset/it, koleget/ët, vartëset/it dhe me publikun, Kolegji i Këshillit, konstaton se shqiptuesi i vërejtjes në aktin e kundërshtuar me ankesë nuk ka ofruar asnjë konstatim apo sqarim, se me cilat veprime i njëjti ka kryer këtë shkelje disiplinore për të cilën është lënë përgjegjës.

Andaj, nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit, konstatoi se ankesa e ankuesit lidhur me shqiptimin e masës së lehtë disiplinore është e bazuar, ndaj vendosi të anuloj *“Vërejtjen me shkrim”*, me numër protokolli 468/25-06/B, të datës 07.10.2025, të shqiptuar ndaj ankuesit nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të AKRK-së, sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi, pasi që konstatoi se akti i goditur me ankesë është paligjshëm sikurse përcaktohet me dispozita e nenit 52 paragrafin 1, nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për shkaqet e dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi.

Lidhur me pranueshmërinë e pretendimeve ankimore të ankuesit për anulimin e Vendimit me numër protokolli 469/25-13/B, të datës 07.10.2025, të Komisioni Disiplinor i AKRK-së, bazuar në nenin 59 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, përmes të cilit ka pezulluar përkohësisht nga puna ankuesin, në kohëzgjatje prej tridhjetë (30) ditëve, duke filluar nga data 08.10.2025 deri më 06.11.2025, për arsye të inicimit të pesë (5) procedurave disiplinore ndaj tij, gjegjësisht dy (2) procedurave disiplinore të datës 25.09.2025 të iniciuar nga Kryetarja e AKRK-së dhe Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të AKRK-së, si dhe tri (3) procedurave disiplinore të iniciuar nga ky i fundit me datë 06.10.2025, Kolegji i Këshillit, analizoi vendimin e kontestuar me ankesë, dhe si rrjedhojë konstatoi se baza ligjore mbi të cilën është nxjerrë i njëjti, është mbi dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht në nenin 59 paragrafi 4, ku përcaktohet se: *4. Nëse ka arsye të besohet se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga nëpunësja/i civil, ndaj të cilës/it ka filluar një procedurë disiplinore pengon hetimin disiplinor apo mund të cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së saj/tij, komisioni disiplinor mund të vendosë pezullimin e përkohshëm nëpunës/it civil ose të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme, deri në marrjen e vendimit përfundimtar. Vendimi për pezullim sipas këtij paragrafi, është veprim i ndërmjetëm procedural ndaj të cilit nuk lejohet ankesa.*, dhe si rrjedhojë referuar dispozitave përkatëse ligjore, Kolegji i Këshillit, konstatoi se nëpunësi civil nuk ka të drejtë të parashtroj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndaj vendimit për pezullimin e përkohshëm ndaj të cilit ka filluar procedura disiplinore, ngase i njëjti është vendim i ndërmjetëm i cili nxjerrët për shkak të mos pengimit të hetimeve apo cenimit për ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij, dhe se ankesa nuk është e lejuar sikurse përcaktohet me nenin 59 paragrafin 4 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Si rrjedhojë e kësaj dhe duke marr parasysh faktin se ankuesi nuk ka të drejtë të parashtrojë ankesë ndaj vendimit për pezullimin e përkohshëm, Kolegji i Këshillit konstaton se në rrethanat e rastit konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për pranueshmërinë e ankesës në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.4 ndërlidhur me nenin 125 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi, përkatësisht të aprovohet si e bazuar ankesa lidhur me shqiptimin e masës së lehtë disiplinore, rrjedhimisht të anulohet *“Vërejtja me shkrim”* me numër protokolli 468/25-06/B, e datës 07.10.2025, e shqiptuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës së Republikës së Kosovës, ndërsa të hedhet

poshtë si i palejuar pretendimi për anulimin e Vendimit për pezullimin e përkohshëm, me numër protokolli 469/25-13/B të datës 07.10.2025, të Komisionit Disiplinor në Autoritetin e Konkurrencës së Republikës së Kosovës.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

## **KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

*Lënda me numër A.nr.1823/2025*

**Atdhe GASHI**

---

Procesmbajtës

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

---

Kryetare e Kolegjit

### **Vendimi i dorëzohet:**

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit, Avokatit Hilmi Shala;
- Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe Komisionit Disiplinor në Autoritetin e Konkurrencës së Republikës së Kosovës; si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së